|  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |  |
|--|--|--|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|  |  |  | <p>materiale jep AKMC per operacionet per perballimin e emergjencave civile?</p> <p>Bazuar në Ligjin nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) luan një rol qendror në sistemin kombëtar të mbrojtjes civile. AKMC garanton hartimin e politikave dhe strategjive për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, si dhe koordinon në nivel kombëtar të gjitha strukturat përgjegjëse për përballimin dhe menaxhimin e emergjencave civile.</p> <p>Në kuadër të mbështetjes për operacionet në terren, AKMC siguron drejtimin, koordinimin dhe monitorimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe vendore, duke mundësuar një reagim të shpejtë, të integruar dhe efektiv. Përmes rolit të saj koordinues, Agjencia garanton që burimet materiale, njerëzore dhe logjistike të strukturave operacionale të</p> |  |
|--|--|--|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|

|  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |  |  |
|--|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
|  |  |  | <p>përdoren në mënyrë sa më efikase për mbrojtjen e jetës, mjedisit dhe infrastrukturës.</p> <p>Cfare kapacitetesh teknike ka AKMC per mbrojtjen civile? Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), në përmbushje të detyrimeve të saj ligjore sipas Ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, ka ngritur dhe përdor një sërë kapacitetesh teknike bashkëkohore për garantimin e një menaxhimi sa më efektiv të emergjencave civile.</p> <p>AKMC administron sisteme të paralajmërimit të hershëm dhe të monitorimit të situatave me risk, duke siguruar informim në kohë reale dhe parashikueshmëri më të lartë për institucionet përgjegjëse dhe publikun. Gjithashtu, përdoren dronë me teknologji të avancuar, të pajisur me kamera optike dhe termike, që mundësojnë identifikimin,</p> |  |  |
|--|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|

|  |  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |  |  |
|--|--|--|--|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
|  |  |  |  | <p>vëzhgimin dhe kontrollin e vatrave të rrezikut, si dhe lehtësojnë koordinimin e forcave operacionale në terren.</p> <p>Nëpërmjet këtyre mjeteve teknike dhe teknologjive moderne, AKMC forcon kapacitetin kombëtar për parandalim, reagim dhe koordinim të integruar, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit.</p> <p>AKMC si e ka organizuar punën, për ngritjen e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile në nivel qendror e vendor?</p> <p>Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, e ka organizuar punën e saj në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile si në nivel qendror, ashtu edhe në atë vendor, përmes një qasjeje të integruar dhe gjithëpërfshirëse.</p> |  |  |
|--|--|--|--|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|

|  |  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |  |
|--|--|--|--|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|  |  |  |  | <p>AKMC harton dhe zbaton politika, strategji dhe plane veprimi për forcimin e kapaciteteve institucionale, duke siguruar trajnime të specializuara për personelin, zhvillimin e ushtrimeve kombëtare e rajonale, si dhe shkëmbimin e praktikave më të mira me partnerë ndërkombëtarë. Në nivel vendor, Agjencia asiston bashkitë në hartimin e planeve të emergjencave civile, në vlerësimin e riskut dhe në ngritjen e strukturave përgjegjëse, duke i pajisur ato me udhëzime teknike dhe mbështetje për rritjen e aftësive të tyre operacionale.</p> <p>Nëpërmjet këtyre masave, AKMC siguron një sistem të mbrojtjes civile të qëndrueshëm, të koordinuar dhe të aftë për t'iu përgjigjur me efikasitet çdo situatë emergjente.</p> <p>Sa inspektime ka kryer AKMC për mbrojtjen civile në subjektet shtetërore dhe private?</p> |  |
|--|--|--|--|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|

|  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |  |
|--|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|  |  |  | <p>Gjatë vitit 2023, AKMC ka realizuar gjithsej 52 inspektime, prej të cilave 31 në institucione qendrore, vendore dhe rajonale, si dhe 21 në subjekte private. Në përfundim të procesit të inspektimit, në 16 raste janë vendosur masa administrative me gjobë.</p> <p>Në vitin 2024, janë kryer inspektime në 24 bashki dhe prefektura, duke përfshirë edhe rastet e riinspektimit. Në 4 raste janë vendosur masa administrative me gjobë.</p> <p>Gjatë vitit 2025 (deri në muajin gusht), janë realizuar 52 inspektime nga ato të planifikuara.</p> <p>Si është bashkepunimi me bashkite persa i perket mbrojtjes civile?</p> <p>Bashkëpunimi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) me bashkitë është i ngushtë dhe i strukturuar në</p> |  |
|--|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|

|  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |  |
|--|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|  |  |  | <p>kuadër të Ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”. AKMC asiston bashkitë në zhvillimin e planeve të emergjencave civile, vlerësimin e riskut dhe ngritjen e strukturave vendore të mbrojtjes civile, duke u siguruar udhëzime teknike, trajnime dhe mbështetje në koordinimin e veprimeve operacionale.</p> <p>Gjatë emergjencave, AKMC siguron koordinimin dhe mbështetjen e bashkive në operacionet që ato kryejnë, duke mundësuar mobilizimin e ndihmës nga bashkitë fqinje ose prefekturat. Kur kapacitetet kombëtare janë të ezauruara, Agjencia organizon dhe koordinon mbështetjen nga partnerë ndërkombëtarë ose burime të jashtme, për të garantuar një përgjigje të shpejtë, efektive dhe të integruar, duke mbrojtur jetën, infrastrukturën dhe mjedisin.</p> <p>Çfarë është</p> |  |
|--|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|



|  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |  |
|--|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|  |  |  | <p>gjithashtu e rëndësishme, mbështetja e NJVV-ve me fond të dedikuar nga programi buxhetor i EC në formën e transfertës së kushtëzuar (VKM-së nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të Fondit të Kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile”, e ndryshuar me VKM-së nr. 290, datë 17.5.2023), fondit kapital për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, fondit për rehabilitim diga/vepra të menaxhimit të burimeve ujore, fondit për mbulimin dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.</p> <p>A ka nje propozim per ndryshim ligji nga AKMC persa i perket mbrojtjes civile?<br/> Çdo propozim ndryshimesh publikohet përmes procesit të konsultimit publik.<br/> Dokumentet e konsultimit publik</p> |  |
|--|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|

|  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |  |
|--|--|--|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|  |  |  | <p>(ku AKMC propozon ndryshime teknike/organizative) gjenden në portalin e konsultimeve dhe në seksionin “Legjislacioni / Konsultime” të AKMC.</p> <p>Me çfare problematikash haset AKMC për mbrojtjen civile? Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) ka bërë hapa të rëndësishëm drejt forcimit të sistemit të mbrojtjes civile në Shqipëri, duke u përfshirë aktivisht në Mekanizmin Evropian të Mbrojtjes Civile dhe duke bashkëpunuar me partnerët evropianë për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira. Megjithatë, krahasuar me vendet e tjera të Evropës, kapacitetet tona operacionale në nivel lokal mbeten të kufizuara, sidomos në disa bashki që nuk disponojnë resurset e nevojshme për të menaxhuar vetë emergjencat. Roli i AKMC-së është të koordinojë,</p> |  |
|--|--|--|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|

|  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |  |  |
|--|--|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
|  |  |  | <p>mbështesë dhe fuqizojë strukturat vendore, duke siguruar që, kur kapacitetet kombëtare janë të tejkaluara, të mund të merret ndihma nga partnerët europianë dhe të implementohen masa efektive për mbrojtjen e qytetarëve.</p> <p>A është kryer një analizë nga AKMC për dëmet e zjarreve në vitin e 2025? Në përfundim të sezonit të zjarreve, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) kryen analizat e nevojshme mbi pasojat e tyre, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”. Për të siguruar një pasqyrë të plotë dhe të saktë, bashkitë kanë detyrimin ligjor të evidentojnë dhe raportojnë dëmet e shkaktuara në territorin e tyre. Bazuar në këto të dhëna të paraqitura nga bashkitë, AKMC përgatit analizat e nevojshme dhe koordinon masat për menaxhimin e pasojave, si dhe për forcimin e kapaciteteve vendore të</p> |  |  |
|--|--|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|

|  |  |  |  |                                  |  |  |
|--|--|--|--|----------------------------------|--|--|
|  |  |  |  | përgjigjes ndaj<br>emergjencave. |  |  |
|--|--|--|--|----------------------------------|--|--|